

HELENA GRILLO (MUKLI)
MIRANDA ENESI (SHAHINI)

**HULUMTIME MBI NJOHJEN, KUPTUESHMËRINË
E PËRDORIMIN E FJALIVE KUSHTORE**

Abstrakt

Studimet e sotme gjuhësore duhet të orientohen drejt gjuhësisë së aplikuar dhe problematikave që dalin prej saj, duke u mbështetur në hulumtime të përdorimeve ligjërimore. Në ditët e sotme lind nevoja e studimeve morfosintaksore, të cilat vëzhgojnë ndikimin e disiplinave të integruara.

Punimi ynë është një qasje drejt matjeve të përdorimeve të kuptimeve gramatikore të kohëve të foljeve dhe mënyrës si ndikojnë këto kuptime gramatikore në përdorimin dhe përvetësimin e periudhës me fjali të varur kushtore. Nëpërmjet matjeve synohet të vëzhgohet kahu i zhvillimeve të sotme të sintaksës së shqipes. Matjet do të realizohen me nxënësit e klasës së 9-të të ciklit të lartë, moshë ku mendohet se ka përfunduar përvetësimi dhe zotërimi i saktë i standardit të shqipes.

Gjuhëtarët e cilësojnë periudhën me fjali të varur kushtore si një fjali që shpreh marrëdhënien shkak-pasojë. Konstatojmë se në tekstin shkollor “Gjuhë shqipe”, 9 të Shtëpisë Botuese Albas, me autorë: Rita Petro, Adelina Çerpja, Idriz Metani nuk trajtohet dhe nuk përmendet në njohuritë gjuhësore, Pjesa II – Sintaksë, fjalia kushtore. Ky problem e tejkalon hapësirën e trajtesës sonë, por theksojmë se matjet janë realizuar në nxënës që punojnë me këtë tekst dhe rezultatet e matjeve domosdoshmërisht janë të varura nga njohuritë që parashtrohet teksti.

Vështrim i përgjithshëm

Periudha me fjali të varur kushtore shpreh marrëdhënie kusht-pasojë, e cila do të thotë që realizimi i kushtit do të sjellë një pasojë.¹ Ajo në pjesën e varur shpreh një kusht të mundshëm ose jo dhe në pjesën kryesore shpreh rezultatit e mundshëm ose hipotetik që përftohet në varësi të

¹ Akademia e Shkencave, *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2002, f. 580.

kushtit dhe kohës së realizimit të tij. Ajo paraqet dy veprime a gjendje të ndërruarura midis tyre në mënyrë të tillë që realizimi ose mosrealizimi i asaj që thuhet në fjalinë e varur, bën të pashmangshme, të mundur ose të pamundur atë për të cilën bëhet fjalë në fjalinë drejtuese.

Ka pasur trajtesa të ndryshme nga gjuhëtarë mbi fjalinë kushtore dhe ne do parashtrojmë disa prej tyre, kryesisht ato që afrohen me mënyrën tonë të trajtimit të varësisë së kohëve të foljeve në pjesën e nënrenditur kushtore duke e ballafaquar me trajtesën e Gramatikës së gjuhës shqipe, botim i Akademisë së Shkencave.

Ilia D. Sheperi në “Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe”, Vlorë 1927, e përmend fjalinë kushtore kur flet për mënyrën kushtore: “*Kushtorja e shfaq vepërimin si qëllim ose përfundim të një kushti, i cili shfaqet me fjali të dytë (fjali kushtore) ose nënkuptohet. P.sh.: Të mos kishja punë do të kishja ardhur.*”²

M. Lambertzi ka trajtuar paralelisht me mjetet lidhëse të fjalive në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore edhe kohën dhe mënyrën e foljes kallëzues të fjalisë së nënrenditur që fillon me lidhëzën përkatëse, por gjithashtu edhe kohën dhe mënyrën e foljes kallëzues me të cilën bashkëlidhet në fjalinë drejtuese, madje në fund të monografisë ai ka paraqitur në një tabelë përmbledhëse të numërtuar deri në 37 raste të mbledhura të bashkëlidhjes së trajtave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues në të dyja fjalitë që ndërtojnë periudhën hipotetike, sipas lidhëzave përkatëse apo sipas mjeteve dhe formave të tjera me të cilat del se janë shprehur raportet kushtore në atë periudhë.

At Justin Rrota në tekstin e tij të gramatikës trajton këto çështje nga raportet kushtore:

1. Përkufizimin e fjalisë së nënrenditur kushtore që ai e quan qyshkore (kondicionale): “*Fjalit qyshkore përmbajn qyshkun, a kushtin mbas së cilit bâhet shka thotë kryefjalija.*”³

2. Lidhëzat dhe lokucionet lidhëzore, me të cilat fjalit e nënrenditur bashkohet me kryesoren, por duke i quajtur ato fjalëza: “*Fjalit qyshkore lidhen me kryefjali nepër fjalzat: Në, në mos, në kjoftë se, në (po) kje se, po kje qi, bâna e.*”⁴

“Kemi njaqë farë fjalish së dyta, sa janë farët a gjymyrët e fjalit së thjeshtë.” Fjalinë e nënrenditur kushtore, të cilën e gjejmë edhe me emrin

² I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927.

³ A. J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. 93.

⁴ Po aty.

kondicionare ai e vendos në grupin e fjalive të ndajfoljorit (adverbialit), pas fjalive vendore, kohore, mënyrore, dhe pikërisht në grupin e fjalive shkajkore (kauzale) pas fjalive shkakore (kauzale) të mirëfillta, dhe pas fjalive qëllimore (finale). Është pikërisht grupi i tretë brenda fjalive shkakore ai në të cilin shprehet kushti i lidhur me veprimin e kryefjalisë dhe, për rrjedhojë, kundërshtimi a pengimi, fjalitë e të cilit janë fjali kushtore (kondicionare).⁵

Cipo në tekstin e tij “Sintaksa” përdor dy emërtime për fjalinë kushtore: Fjalia kushtore-perioda hipotetike. Në gramatikën e tij ai sjell këtë përkufizim të fjalisë kushtore: *“Fjalia kushtore është fjalia që tregon kusht në rrjedhim të së cilës munt të ndodhë e munt të mos ndodhë ç’është thënë në fjalinë kryesore ose në çdo fjali tjetër nga e cila varet kushtorja dhe lidhet me anë të këtyre lidhëzave kushtore...”*⁶

Në gramatikën e S. Priftit trajtimi i periudhës me fjali të nënrenditur kushtore vjen si *“Fjali që përmbahet në fjalinë nga e cila varet, pra fjali kushtore quhet fjalia e varur që tregon kushtin e një pasojë.”*⁷

M. Totoni është autor i teksteve të shkollave tetëvjeçare, i disa artikujve në lidhje me këtë çështje, por në veçanti e ka rimarrë për trajtim më të kujdesshëm në librin “Fraza me nënrenditje”, ku para dhe gjatë trajtimit ndeshemi me termin frazë. Ai sqaron konceptin frazë duke bërë njëherësh dallimin e tij nga koncepti fjali. *“Me frazë do të kuptohet njësi sintaksore ligjërimore që karakterizohet nga intonacioni i mbaruar dhe nga kumtimi i plotë brenda një konteksti të caktuar. Me fjali do të kuptohet ajo njësi sintaksore që ka në bazë një folje të shtjelluar. Fjalia është thjesht strukturë që mund të formulizohet.”* Te ky autor ndeshemi për herë të parë me klasifikimin e lidhëzave në: lidhëza me kuptim të diferencuar dhe me kuptim të padiferencuar, si edhe me rolin që ato luajnë vetëm apo në bashkëveprim me bashkëlidhjen kohore a mënyrore të foljeve në fjalitë kryesore dhe të nënrenditur, në përcaktimin e llojit të marrëdhënieve kushtore si të mundshme a të pamundshme.

Për Th. Dhimën “Marrëdhëniet kushtore realizohen nëpërmjet lidhëzave nënrenditëse kushtore, bashkëlidhjes së formave mënyrore e kohore të foljeve kallëzues të pjesëve dhe nëpërmjet kontekstit.”⁸

⁵ A. J. Rrota, *Gjuha e shkrueme, vërejtje gramatikore*, ASHRSH, IGJL, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 93

⁶ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë 1952, f. 95.

⁷ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, mars 1971, Prishtinë, f. 386-387.

⁸ Th. Dhima, *Gjuha shqipe, Sintaksa*, SHBLU, Tiranë 2005, f. 196.

Metoda

Materiali teorik do të na shërbejë për krahasime të mendimeve të ndryshme të gjuhëtarëve për trajtesën teorike të dukurisë që vëzhgojmë.

Sprova për ndërtimin të një testi gjuhësor, i cili do të masë shkallën e zotërimit të gjuhës, e kryesisht përdorimin e fjalive të nënrenditura kushtore është sprovë për kërkime të tilla në fushën e gjuhësisë, ku më shumë se kurrë nevojiten matje konkrete e punime në fushën e pragmalinguistikës. Vërejmë se testi është i përshtatshëm vetëm për bashkësinë gjuhësore të fëmijëve shqiptar dhe matjet janë realizuar brenda strukturave gramatikore të gjuhës shqipe.

Pjesë e studimit do të bëhen fëmijët e arsimit 9-vjeçar, për matje të marrëdhënieve shkak- pasojë kryesisht nxënësit e klasave 6-9 për përdorimin e periudhës me fjali të varura kushtore. Kjo bashkësi gjuhësore që do të përdoret për matje të kuptueshmërisë së kohëve të foljeve, të cilat janë të domosdoshme për përdorimin e drejtë të periudhës kushtore.

Studimi sasior sjell të dhëna që konstatojnë prirjet e zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes, nëpërmjet matjes së përvetësimit të kuptimit e përdorimit të fjalive të nënrenditura kushtore.

Test gjuhësor

1. Plotësoni fjalitë kushtore

1. Në qoftë se do të merren me aktivitet, fëmijët _____
2. Sikur të isha burrëruar, kur e kisha moshën, sot _____
3. Në qoftë se puna e forcave të jashtme është pozitive, atëherë _____
4. Po qe se edhe ajo të vlerëson, _____

2. Ndërtoni dy fjali kushtore:

2.1. Kusht i realizueshëm: _____

2.2. Kusht i parealizueshëm: _____

3. Vendos foljen në mënyrën e duhur:

1. Provoje. Në (pëlqej) _____, haje.
2. I bekuar qofsh, në _____ (jam) arbëresh.

4. Cilin variant përdorni më shpesh:

- a. Le t'i thotë vetë, në është burrë.
 - b. Le t'i thotë vetë, në qoftë se është burrë.
5. Përdor një nga lidhëzat: në rast se/ në qoftë se

Hulumtime mbi njohjen, kuptueshmërinë e përdorimin...

Do të përpiqemi ta shërojmë, po _____ s'do të kemi sukses atëherë s'kemi ç'të bëjmë.

6. Në fjalinë: Unë mendoj se fjalët janë të tepërta, kur një gjë duket fare qartë, lidhëza *kur* ka nuancë:
- a- kohore
 - b- kushtore

Testi ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë të testit pyetësor, pyetjet 1-3 masin nivelin e përvetësimit dhe përdorimit të fjalive kushtore, nëpërmjet varësisë nga modaliteti i foljes së përdorur duke i lënë nxënësit të plotësojnë fjalitë e varura kushtore në varësi të kushtit të realizueshëm, ose jo.

Në pjesën e dytë, pyetjet 4-6 masin shkallën e dendurisë së përdorimit të lidhëzave: *në/ në qoftë se; në rast se/ në qoftë se*, si dhe shkalla e nuancave kuptimore të mjetit lidhëz *kur*.

Hipoteza

Ne konstatojmë se nxënësit kanë probleme me kuptueshmërinë e kushtit të realizueshëm ose jo, rrjedhimisht kanë problem dhe me përdorimet gramatikore të mënyrës së foljes që ndërtohen kushtet e realizueshme, ose jo. Kjo shkakton moskuptueshmëri të frazave në ligjërim dhe mospërdorim të fjalive kushtore.

H. 1. Njohja e kuptimeve gramatikore të foljeve ndikon në krijimin dhe përdorimin e fjalive të nënrenditura kushtore, të cilat vijnë si rezultat i marrëdhënieve kusht – pasojë.

Pas përcaktimit të problemit shtrohen pyetjet: në kemi të bëjmë me probleme specifike që lidhen me gramatikën, apo trajtesa të pamjaftueshme nga tekstet. Problematika me tekstet i tejkalon hapësirat e trajtesës sonë, por theksojmë se në tekstet e gjuhës shqipe anashkalohet trajtimi i fjalive kushtore.

Për pjesën e dytë të testit shtrojmë pyetjen:

A kushtëzohet përzgjedhja midis përdorimeve nga faktorë jashtëgjuhësor (mosha, gjinia) apo vetëm gjuhësorë e logjikë (formues)?

Rezultatet

Në analizën e rezultateve do të mbështetemi në interpretimin se *kuptimi tërësor gjuhësor i një shprehjeje përbëhet nga kuptimet leksikore të fjalëve të veçanta dhe “kuptimeve strukturore”*⁹

Në termin “kuptim strukturor” të Fries-it përmbliidhen, së paku tre tipa të ndryshëm funksionesh semantike:

1. Kuptim i elementeve gramatikor (karakteristikë për pjesët dytësore të ligjëratës dhe kategoritë gramatikore).

2. Kuptimi i funksioneve gramatikore, si: kryefjalë, kundrinor, element përcaktor.

3. Kuptimi në kuadrin e klasifikimit të tipave të ndryshëm të fjalisë, që lidhet me koncepte “dëftor”, “pyetës”, ose “urdhëror”. Përgjithësisht nga analiza e rezultateve të testit vërejmë se fëmijët kanë defekte në tipin e parë dhe të tretë të funksioneve semantike që lidhen me “kuptimin strukturor”.

Në analizë do të kemi parasysh se: *kompetenca e një subjekti që flet gjuhën shqipe shpjegon mundësinë që ai ka të ndërtojë të njohë dhe të kuptojë frazat gramatikore, të kuptojë dhe interpretojë frazat e dykuptimshme, të prodhojë fraza të reja.*¹⁰


Testi gjuhësor mat kuptueshmërinë e frazave gramatikore dhe prodhimin e frazave të reja. Rezultatet e matshme të testit do të na shërbejnë për përcaktimin e shkaqeve të përdorimeve të gabuara të periudhës kushtore duke shprehur varësinë e këtyre përdorimeve nga njohja mbi kuptueshmërinë gramatikore të kohëve të foljeve.

Tabela 1. (Pjesa e parë)

Nr i ndërtimeve kushtore	Nr i parealizueshëm
42 nxënës	18 nxënës

⁹ J. Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2011, f. 402.

¹⁰ T. Plangarica, *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, Shtëpia Botuese “Sejko”, Elbasan, 2002, f. 52.



Nga rezultatet e tabelës 1 vëzhgojmë se 70% të nxënësve u përgjigjen kërkesave krijuese për plotësimin e fjalive kushtore me kusht të realizueshëm, ose jo. Ata përdorin përgjithësisht kohën e ardhme për kushtet e realizueshme. Nxënësit hasin vështirësi në ndërtimin e fjalive kushtore në të cilat pasojat, përmbajtja e fjalisë drejtuese, është rezultat i pashmangshëm i kushtit që shprehet në fjalinë e varur. Këto janë periudhat që formulohen ligjet natyrore e shoqërore që shprehin kushtëzim midis fakteve dhe dukurive të realitetit. Ky tregues dëshmon se nxënësit njohin përgjithësisht pak ligjet natyrore e shoqërore, që sjell dhe pasoja në formimin e tyre të përgjithshëm.

Në fjalinë e marrë si shembull nga “Gramatika e gjuhës shqipe 2”: *Në qoftë se puna e forcave të jashtme është pozitive, atëherë energjia e sistemit rritet* vërehet se përgjigjet nuk janë logjike. Kjo dëshmon faktin se nxënësit nuk njohin ligjet e shkencave natyrore. Disa nga përgjigjet e tyre janë: *Në qoftë se puna e forcave të jashtme është pozitive, atëherë do të ishte më e lehtë për ne, mendoj se do t’ia dalësh, do të ushtrohem më shumë, gjithçka do të rregullohet, dhe çështjet konkrete janë në rregull, s’kemi pse të merakosemi.*

Përgjithësisht nxënësit përdorin mirë fjalitë që vendosin marrëdhënie kusht – pasojë sipas fakteve të supozuara a të dëshiruara në kundërshtim me realitetin e pranishëm. Përmbajtja e këtyre periudhave është aktualisht e parealizueshme.

P.sh.: *Sikur të isha burrëruar, kur e kisha moshën, sot do të ndihesha më i rëndësishëm, do të ishte ndryshe, do të veproja më ndryshe, nuk do të qëndroja, nuk do të isha si jam, do të isha më i fortë, etj.*


Përdorin mirë fjalitë në të cilat pasoja është një arsytim, një vlerësim, një pyetje, një urdhër këshillë a dëshirë mbi bazën e një supozimi të caktuar, p.sh.: *Po qe se edhe ajo të vlerëson, gëzohem shumë që gjeti një njeri si ty.*

Shpesh konstatohen gabime në përcaktimin e kushteve të realizueshme dhe të parealizueshme. 30 % e nxënësve nuk plotësojnë kërkesën e testit për ndërtim të fjalive kushtore dhe mendojnë se faktorë kryesorë nuk janë vetëm gjuhësore, njohja mbi fjalinë kushtore dhe kuptimet gramatikore të foljeve, por edhe jashtëgjuhësore që lidhen me formimin e përgjithshëm të tyre.

Vërehen gabime në ndërtim: *Provoje. Në të pëlqeftë haje, në s'të pëlqeftë lëre.* Pothuajse 90% e nxënësve nuk ndërtojnë fjalinë kushtore me foljen në kohën e duhur, duke vërtetuar hipotezën e varësisë së njohjes së kuptimit gramatikor të dëshirores.

Tabela 2. (Pjesa e dytë)

Pyetje 4	Përdorimeve të lidhëzës në	Në qoftë se	Asnjë përdorim
Nr.	44	11	5



Lidhëza në dhe lokucionet lidhëzore të formuara me në

Në pjesën e dytë të testit realizojmë matje të përdorimeve të lidhëzave kushtore më të përdorshme: *nëse, në qoftë se, në është se, në rast se.* Fjalitë kushtore me lidhëzën *në qoftë se* tregojnë kusht të përcaktuar mirë, pa nuancë stilistiko-emocionale. Ato shprehin një kusht me një trajtë të spikatur qartë për këtë arsye janë tipi mbizotërues në stilin publicistikoshkencor. Ato shprehin një kusht të mundshëm apo të pamundshëm në çastin e ligjërit.

Hulumtime mbi njohjen, kuptueshmërinë e përdorimin...

Fjalitë e lidhura me njërën prej tyre shprehin një kusht të mundshëm, të dëshirueshëm ose thjesht një supozim. Ato përdoren në të gjitha stilet gjuhësore por mbizotërojnë në stilin letrar kjo për shkak se folja në mënyrën dëshirore është e përshtatshme për të shprehur ngjyime emocionale, nga ana tjetër, struktura njërrrokëshe e lidhëzës e bën atë më koncize dhe më të volitshme për tu përdorur.

Nga matjet vërehet se ndër 60 nxënës, 5 prej tyre nuk përdorin asnjë nga mjetet lidhëze. Ka përparësi përdorimi i lidhëzës *në*, kundrejt *në qoftë se*. Kjo mendojmë se ka fituar denduri përdorimi për shkak të ekonomizmit gjuhësor, dhe faktit se gjuha e folur po afrohet me shpejtësi duke ndikuar mbi gjuhën e shkruar.

Tabela 3.

Pyetje 5	Përdorimeve të lidhëzës në rast se	Në qoftë se	Asnjë përdorim
Nr.	33	27	0



Periudhat e lidhura me lokucionin lidhëzor *në rast se* e kanë më të theksuar karakterin rastësor të supozuar të vërtetimit të kushtit sesa fjalitë me *në qoftë se* megjithatë një dallim i qartë në mes të tyre nuk mund të bëhet. Kjo tregohet dhe në rezultatet e matjeve të mësipërme ku ka pak luhatje në përdorim dhe pothuajse përdoruesit kanë krijuar qëndrueshmëri, gati 45% me 55 %. Ato përputhen plotësisht me njëra tjetrën nga ana strukturore, nga trajtat foljore me të cilat formohen, nga bashkëlidhja kohore e foljeve-kallëzues të të dy fjalive si dhe nga rendi i gjymtyrëve të fjalisë.¹¹

¹¹ Gramatika e gjuhës shqipe – Tiranë: Akademia e Shkencave, 2002, f. 586

Fjalitë e ndërtuara me lidhëzën *kur*

Fjalitë e ndërtuara me lidhëzën *kur* shprehin kryesisht marrëdhënie kohore; megjithatë, kushtëzimi i një fakti prej një tjetri mund të shprehet dhe me fjalitë e ndërtuara me këtë lidhëz; kur fakti që jepet në fjalinë e varur me lidhëzën *kur* shërben jo për të treguar kohën e zhvillimit të veprimit të foljes-kallëzues të fjalisë drejtuese, por kushtin e realizimit të tij. Pra dalin në plan të parë marrëdhëniet kushtore. Në të tilla raste, shpesh, krahas marrëdhënieve kushtore zotëruese, nuk mungojnë edhe ngjyrimet kohore. Kjo shtrirje e mënyrës së shprehjes së marrëdhënieve kushtore është bërë e mundur nga disa tipa të fjalive me lidhëzën *kur* kanë po atë strukturë, po atë bashkëlidhje kohore me disa tipe të fjalive kushtore.¹²

Tabela 4.

Pyetje 6	Përdorimeve kohore	nuancë	Nuancë kushtore	Asnjë përdorim
Nr.	32		25	3



Nga matjet rezulton se 3 përgjigje nuk vlerësojnë te lidhëza *kur* as nuancë kohore e as kushtore, ndërkohë që nuk ka luhatje të mëdha mes nuancës kohore e kushtore.

Rezultatet e punimit do të përdoren nga mësimdhënësit dhe hartuesit e teksteve të gjuhës shqipe në ndihmë të përdorimit më të mirë të standardit të shqipes.

Në një trajtesë tjetër punimi do t'i paraprijë studimit të përvetësimit të gjuhës së dytë, anglishtes duke pasur parasysh përafrimet midis dy gjuhëve.

¹² Gramatika e gjuhës shqipe – Tiranë: Akademia e Shkencave, 2002, f. 590.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave. (2002). *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë,
Dhima, Th. (2005) *Gjuha shqipe, Sintaksa*. SHBLU, Tiranë.
K. Cipo. (1952). *Sintaksa*, Tiranë.
Lyons, J. (2011). *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Shtëpia Botuese Dituria,
Tiranë.
Plangarica, T. (2002). *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*. Shtëpia Botuese
“Sejko”, Elbasan.
Prifti, S. (1971). *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë.
Rrota, A. J. (2005). *Sintaksi i shqipes*. Botime Françeskane, Shkodër.
Rrota, A. J. (2006). *Gjuha e shkrueme, vërejtje gramatikore*, Shkodër.
Sheperi, I. D. (1927). *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë.

**LEKSIKOLOGJI,
TERMINIOLOGJI,
GJUHËSI E ZBATUAR**

